

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHOYPTARE

4-5

Prill-Máj 1943-XXI.

VJETI XIX.

S H K O D E R

Pajtimi per të perkohshmen „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer	Fr. 1.50	Nji vjetë	Fr. 15.—
Itali	» »	» 1.50 *	» »	» 15.—
Nder vende tjera . .	» »	» 2.—	» »	» 30.—

Themelue në vjetin 1913 prej At Gjergj Fishtës

PERMBAJTJA

P. MARIN SIRDANI — Kulturë e arte në Shqipni	FAQE	101
JAM — Qellzoret e gjuhës shqype		115
OSMAN MYDERRIZI — Emni i Shqipnisë në kohën e mesme		122
EPRI — Matutini		137
A. BERNARDIN PALAJ — Doke e Kanú në Dukagjin		144
Dr. V. SAMIM VISOKA — Horizonte të reja per shtypin t' onë kombtar *)		151
INJAC GJ. NDOJAJ — Pasunija private e Shqipnis		161
GELASIUS — Fjalori Toponomastik		170
A. BERNARDIN PALAJ — Lule Frangu		179
A. BERNARDIN PALAJ — Djoçezi i Pultit		188
A. P. BARDHI — Udhtimi i t' Emzot Marin Bizzi-t, kryeipeshkvit të Tivarit, neper Shqypni		196
At GJON SHLLAKU — Rreth çashtjes s' Alfabetit të Monastirit		202
A. D. KURTI — Prralla. — Blë. II. Fash. 16,		

*) Nder këta numra botojm një artikull të Z. Dr. V. Samim Visoka permbi gjendjen e vertetë të bulkut e të bujqsis në Shqipni. Asht e dijtun, se parimet, mbas të cillavet kundrohen çashtjet njerzore, janë të matuna e të peshueme gjithmonë simbas botëkuptimevet të ndryshme. Asht e vertetë, se gjendja e bulkut t' onë asht më e mjerueshmja e çdo gjendjes së bujqvet t' Europës shi per arsye të diferencës së botëkuptimevet historike, qi randuen permbi ketë bulkun t' onë.

Drejtimi u lutet të gjithë Bashkëpunorvet të vet, qi duen të rrahin këso çashtjesh e në këto krize botëkuptimesh, të jën të kjarhtë nder parime, prej të cillavet do të bëjnë me rriedhë zhvillimin e ndonjij argumenti me randsi aktuale.

REDAKSIJA

HYLLI I DRITËS

EPERKOHËSHME KULTURALE-LETRARE

Kulturë e arte në Shqipni

(Vijon prej Nr.vef 1-3 fq. 7)

II. Perjudha ilirike

Si kemi tregue syfri ¹²⁾, jo veç Shqipnija, por edhe nji pjesë e mirë e Europës, qyshë në kohë shum të hershme, ishte e banueme prej njaj populli të quejtun Ilir. Ky popull i madh, qi në rrymen e shekujve shkoi tue u njinjisue me popuj tjerë e nuk la veç nji numer të vogel trashigimtarësh në Shqiptarët e sodshem ¹³⁾, gjatë moshës së metalave ka nji randsí të posaçme per fuqin e zgjanimit të vet e per rolin qi luejti në zhvillimin e popujve n' Europen qendrore e n' atë jug-lindore. Ket randsí historike, Franz Altheim, nji nder auktoritete të permenduna të botës së sodshme, e permbledhë me këto fjalë: „Në mbarim të XIII shekull para Krishtit Ilirasit fituen per të paren herë nji randsí historike botnore. Gjithkund fuqija e tyne ndiehet e shâmja e tyne perpara si edhe perhapja e tyne. E ata kjenë fuqija shtÿse qi shkaktoi dyndjen egjeike. Bashkë me Trak-frigas shân ata kahë jug-prendimi: me Dorasit neper Greçi kahë jugu, me Italasit Osk e Umbras mbrenda gadishullit Apenin. Ata kjenë shkaktarët e kësaj dyndje e njikohsisht edhe perbarsit. Në gollen prendi-

¹²⁾ — Vro numrin e perparshem të kësaj perkohshme, n. 1-3, f. 5-7.

¹³⁾ — Stadtmüller (Vro ket perkohshme, v. 1942, n. 1-2, f. 17) thotë: „Shqiptarët janë bashkë me Grekët i vetmi popull i vjetersís në Ballkan, prej të cilve nji pakicë mujti me shpetue prej romanizimit. Pasardhsit e kësaj pakice janë Shqiptarët e sodshem“.

